



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 84

Prishtinë, më 1.7.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Arben Gashi, Arsim Bajrami dhe Mufera Shinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Visar Smajlaj, ekspert, Armend Shkoza - LVV, Driton Selmanaj-KDI, Vlora Nushi - ORA/srso, Behlul Zeka - EUSR, Shkodran Gajraku- “Klan Kosova”, Fitim Gashi – “Koha ditore”, Valmira Saraçi – “KTV”, Leonora Berbatoci – “RTK”, Sylë Ahmeti – “Kosova Sot”, Bajram Gecaj- ESEP, Artan Canhasi – EULEX, Lejla Selimi- OSBE, Fidan Rama – “Tribuna”, Erëlehta Podaj – “Kosova Live”, Albana Gashi, deputete, Liburn Aliu, deputet, Donjetë Hoxha – “Birn”, Florent Spahija- “Inter news”.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri dhe Fehmi Hyseni

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.5.2013;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për amnistinë;
4. Të ndryshme .

1. Miratimi i rendit të ditës;

Albulena Haxhiu, shprehu shqetësimin për shkeljet flagrante që po i bëhen Rregullores së Punës së Kuvendit. Sipas nenit 56, të Rregullores së Punës së Kuvendit, shqyrtimin i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë dhe jo më vonë se katër javë, nga dita e shpërndarjes së tij. Ky projektligj është shpërndarë më 27.06.2013 dhe shqyrtimin i tij sot bie ndesh me nenin 56, paragrafin 1, të Rregullores së Punës së Kuvendit, meqë nuk kanë kaluar dy javë pune.

Së dyti, në nenin 64, paragrafi 4, thuhet se anëtarët e Komisionit njoftohen me rendin e ditës, jo më vonë se katër ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Mbledhja e sotme bie ndesh me Rregulloren e Punës së Kuvendit, meqë anëtarët e Komisionit janë njoftuar të premten për mbajtjen e mbledhjes së sotme.

Së treti, është jashtë çdo norme kushtetuese dhe ligjore që Komisioni për Legjislacion të veprojë sipas agjendës së Qeverisë. Këto shkelje të Rregullores së Punës së Kuvendit, bëjnë që ky projektligj të hiqet nga rendi i ditës dhe të shqyrtohet në ndonjë mbledhje tjetër, kur t’i vije radha.

Armend Zemaj, duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësës tha se sa i përket shqetësimit të parë znj. Haxhiu ajo nuk ka të drejtë meqenëse Rregullorja e Punës së Kuvendit thotë se Projektligji nuk mund të shqyrtohet në seancë pa kaluar dy javë pune, mirëpo, kërkoj shpjegim përse ky projektligj duhet të shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar .

Kryesuesi, theksoi se mbledhja është thirrur në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit, kurse për procedurat e përshpejtuara ka vullnet nga liderët e tri partive më të mëdha, që ky projektligj të futet në seancën e radhës.

Arsim Bajrami, tha se vlerësimin e kushtetutshmërisë e bënë Gjykata Kushtetuese, dhe vetëm pasi të miratohet ligji, ai mund të dërgohet për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni me 5 vota “për” , 1 votë “kundër” dhe 2” abstenime” miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.05.2013;

Kryesuesi konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 20.5.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i projektligjit për amnistinë;

Albulena Haxhiu, tha se është dashur të jetë i pranishëm z. Hajredin Kuqi, meqë është ligj që prekë ministrinë që e udhëheq ai. Ky ligj është problematik në tri rrafshë. Me këtë ligj po amnistohet një grup nga ndjekja penale, pra po amnistohen serbët ende pa nisur procedurat e hetimit. Me këtë projektligj po amnistohen krimet ndaj shtetit Kosovës dhe rendit juridik të tij. Po amnistohen strukturat ilegale të Serbisë. Pra, amnistia e vërtetë nuk është për të burgosurit, por për pjesëtarët e MUP-it dhe strukturat tjera që kanë kryer krime ndaj shtetit të Kosovës dhe ndaj popullatës.

Po amnistohen ata që tashmë janë të dënuar, edhe të korruptuarit që vijnë nga partia që e ka pushtetin. Gjithashtu kjo amnisti është jashtë ligjeve në fuqi dhe si e tillë nuk ka bazë juridike dhe bie në kundërshtim me to. Kjo që po ndodhë, nuk është shpërbërje e strukturave ilegale por legjitimim i tyre

Haki Demolli, në fjalën e tij tha se me dispozitat që ka ky projektligj, synohet të amnistohen pjesëtarë të komunitetit serb, të cilët që 14 vite kanë rrezikuar dhe cenuar rendin kushtetues, kanë dëmtuar pronën e qytetarëve të vendit tonë, kanë nxitur urrejtje etnike e fetare, kanë rrezikuar rendin dhe sigurinë tonë, ekonominë tonë dhe kanë kryer vepra të tjera penale në dëm të vendit tonë.

Vërejtja e dytë ka të bëjë me mospërputhjen e memorandumit shpjegues dhe dispozitave të këtij projektligji, konkretisht në memorandumin shpjegues, si objektiva të këtij projektligji theksohen humanizmi, rrezikshmëria e ulët e personave dhe mbrojtja e interesit publik, kurse me dispozitat e projektligjit lejohet amnistia për vrasësit, për persona që kanë bërë vepra penal, ku dënimi është prej 5 deri në 25 vjet si p.sh. kryengritja e armatosur etj.

Vërejtja e tretë, numri i madh i veprave penal për të cilat parashihet amnistia , që janë afro 100 të tilla. Numri dhe veprat të cilat amnistohen, duhet të reduktohen.

Ardian Gjini, theksoi se duhet të dimë se pse po kërkohet të bëhet amnistia, pse po kërkohet të amnistohen ata që kanë shkelur rendin juridik dhe kushtetues të Kosovës. Për shkak se pra po u nevojitet amnistia. Pra kjo është amnisti politike e jo humanitare. Këtë e kanë bërë edhe vendet e tjera në rajon. Edhe Kosovës pra, i duhet ta mbyll këtë kapitull, por jo edhe të përfitojnë nga kjo amnisti edhe pjesë tjera, personat e krimit ordiner.

Halit Krasniqi, vlerësoi se si jurist është e vështirë të mos i vësh ato pikat e dhimbshme të këtij projektligji. Do të jetë e vështirë të kalojmë pa pasoja, kur të amnistohen gjithë këto vepra. Do të jetë shumë vështirë të jap pëlqimin për këtë projektligj. Kontributin tim do ta jep në seancën plenare. Jam që ta kalojmë në parim dhe ta dërgojmë në seancë.

Armend Zemaj, shprehu qëndrimin e tij se pse edhe vitin e kaluar ishte kundër asaj që disa subjekte të caktuara politike kanë kërkuar të ndryshohet Kushtetuta dhe të futet amnistia. Kjo sepse e kam vërejt që institucionet tona nuk janë të përgatitura për një ligj të tillë. Përfshirja e disa veprave është shumë skandaloze, tendencioze dhe johumane.

Duke arsyetuar mendimin e tij, Zemaj tha se gjatë fazës së tranzicionit në Kosovë sidomos pas lufte, kanë ndodhur shumë gjëra të këqija si nga persona, struktura dhe parti politike, e që disa prej tyre tash amnistohen me këtë ligj, prandaj vota ime do të rezervohet nëse nuk reduktohen disa nga veprat që janë përfshirë në këtë Projektligj.

Gëzim Kelmendi, tha se përgjegjësia për ta shqyrtuar këtë Projektligj bie mbi ne si Komision dhe duhet të kemi parasysh që për miratimin e këtij ligji nevojitet vota e 2/3 të deputetëve dhe mos të ngutemi me procedurat e përshpejtuara. Ai shfaq vërejtjet e tij në nenin 3 dhe 5, të Projektligjit lidhur me përfshirjen e disa veprave.

Liburn Aliu, theksoi se amnistia ndodh kudo, por amnistia sipas këtij projektligji buron nga marrëveshja Kosovë- Serbi. Karakteristikë e kësaj marrëveshje është se i amnistion plotësisht strukturat, kurse individët pjesërisht. Rreziku për shoqëri është shumëfish më i madh nga strukturat se sa nga individët, andaj kjo karakteristikë do të duhej të ishte e përmbysur, pra të amnistohen individët e jo strukturat. Ekziston lidhja gjithmonë mes strukturës kriminale dhe shtetit. Edhe strukturat në veri nuk janë krijuar vetvetiu. Ligji duhet fuqishëm t'i dënojë strukturat, kurse për individët mund të ketë lejime, sepse kur godasim strukturën arrijmë ta çlirojmë Kosovën nga krimi e korrupsioni.

Albulena Haxhiu, tha se amnistia është mekanizëm që e përdor shteti për persona të caktuar pasi e kanë vuajtur një pjesë të dënimit, e jo akoma pa filluar hetimet. Të burgosurit tashmë janë në grevë urie duke kërkuar nga ne që mos ta votomë këtë projektligj, ligj ky i premtuar nga z. Kuçi, që asnjëherë nuk u bë përderisa nuk e kërkoi Daçiçi në bisedime. Andaj, ju bëj thirrje të mos e votoni këtë projektligj.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni me 4 vota “për” , 1 votë “kundër” dhe 2 abstenime vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L-203 për Amnistinë.

4. Të ndryshme.

Komisioni e shqyrtoi kërkesën nga të burgosurit – grevistët të burgut të Dubravës, dhe vlerësoi se pasi për shqyrtimin e Projektligjit për amnistinë është Komisioni Funksional, pas leximit të parë, ka mundësi që edhe ta amendamentojë konform procedurave parlamentare. Andaj edhe kërkesat e të burgosurve grevistë mund të merren në konsideratë

Mbledhja përfundoi në orën 11:10
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Nënkryetari i Komisionit
Behar Selimi